



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 18.09.2018, me fillim në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i Komisionit Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendës të kryetarit, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, dhe Veton Berisha, anëtarë .

Munguan: Duda Balje dhe Slobodan Petrović, anëtarë .

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetović, (OSBE), Zijush Ahmeti, (KSZ) dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Me dia dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyrtarët për mbështetje të Komisionit: Natasha Prica Tishma dhe Drita Çaraxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Igor Simiq**, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 11.07 dhe 31.07.2018;**
- 3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari, konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 11.07 dhe 31.07.2018;

Kryetari, konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më: 11.7.2018 dhe 31.7.2018, miratohen njëzëri, pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018;

Kryetari, Igor Simiq: Në raportin e punës për vitin 2018, janë të përfshira të gjitha aktivitetet dhe detyrimet e komisionit në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe përgjegjësive nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Në diskutimin e tij tha se Komisioni ka mbajtur 23 mbledhjeve, ka shqyrtuar 43 projektligje dhe janë hartuar raporte me rekomandime për Kuvend.

Komisioni ka ftuar Ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale z. Skender Reçica dhe Ministrin për Komunitete dhe Kthim z. Dalibor Jevtiq lidhur me temën e implementimit të projektit për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë. Në këtë takim ka raportuar Ministri z. Reçica ndërsa nuk ka marr pjesë ministri z. Dalibor Jevtiq, me arsye se agjenda e tij ka qenë e aranzhuar me takime tjera të rëndësishme. I njëjti ka premtuar se në ç'farëdo kohe është i gatshëm të përgjegjësitë të Komisionit. Raportim i komisionerit për gjuhët, z. Slavisha Mladenoviq, nuk është realizuar nga se në të njëjtën ditë ka qenë i ftuar në Konferencën Evropiane, lidhur me temën: svidat rreth zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Konsideron se i njëjti do ta ftohet në takim të Komisionit, në muajin tetor.

Komisioni ka realizuar takimin me Ministrin për Punë të Brendshme z. Bejtush Gashi i cili ka raportuar lidhur me çështjen e shpalljes së konkursit të policisë dhe përfaqësimit të komuniteteve.

Në fajlin e tij tha se është falenderues për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të cilët mbështesin punën e këtij komisioni, siq janë OSBE-ja, Bashkësia Evropiane dhe përfaqësues të tjerë.

Pasi nuk pati propozime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Në bazë të përmbushjes së detyrimeve, Komisioni miratoi raportin e punës për sesionin pranveror 2018.

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;

Kryetari: Me rastin e shqyrtimit të Planit të punës së Komisionit për gjysmën e dytë të këtij viti, mirë është të definohen kuvendet komunale me qëllim që të caktohen kornizat kohore për realizimin e këtij aktiviteti. Ishe i mendimit të vizitohen dy komuna në muaj, në veçanti komunat të cilat janë të banuara me popullsi multnietike.

Për ndyshimin dhe plotësimin e planit të punës, fjalën iu kalojë anëtarëve të komisionit.

Xhelal Sveçla : Mendon se detyrat e parealizuara në bazë të Planit të Punës të sesionit pranveror të barten në sesionin vjeshtor. Propozim i tij konkret ishte që të vizitohet komuna e Shtërpçës dhe komuna e Zubin Potokut, nga se është në interes të ndëgjohen drejtpërdrejtë zërat e tyre lidhur me sfidat dhe rezultatet e arritura, si dhe çështja e grandeve për fermerë, që iu ofron Qeveria.

Si kërkesë e dytë, parashtrij çështjen e ndryshimit të orarit të ftesës së ministrave. Ai dha propozim që të ftohet në raportim ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në muajin tetor, dhe në një periudhë të afërt të ftohet ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Albert Kinolli: Sa i përket planit të punës, është i mendimit të nejtë, se çështjet e paralizuar të barten për periudhën e sesionit vjeshtor.

Ai propozoi që komisioni të vizitoj komunën e Prizerenit. Siq dihet në këtë komunë, përveq komunitetit shumicë shqiptarë jetojnë edhe komunitetet tjera. Është me interes, të kuptohet arsya pse nuk zbatohet përdorimi i gjuhës rome, si gjuhë zyrtare, në këtë komunë.

Veton Berisha: Pajtohet me qëndrimet e kolegëve që komisioni të realizojë vizitat në terren. Si propozim i tij ishte që të vizitohet komuna e Pejës. Aresyet janë të natyrave të ndryshme, veçanërisht të kontaktohet zyra për komunitete lidhur me përfaqësimin e komunitetit egjiptian, nga se ka një peshë të veçantë për këtë komunitet.

Kryetari: Dha propozim konkret, të vizitohet komuna e Graçanicës dhe komuna e Deqanit. E infomoi komisionin, se do të vej kontakte direkte me kryetarët e dy komunave, dhe më pas do të njofojë komisionin, për ditën dhe datën e realizimit të këtyre vizitave .

Në bazë të arritjes së marrëveshjes të anëtarëve të komisioni, do të ftohen në raportim: ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, komisioneri për gjuhët, Slavisha Mladenoviq. Në bazë të planit të punës, Komisioni ka caktuar tri grupe punuese për mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, dhe është i bindur se kyesuesit e grupeve punuese do të jenë më aktiv që të dalin me raport final, deri në fund të viti.

Komisioni ka për kompetencë që periodikisht të kontrollojë planin e vetë të punës dhe aktivitetet e saja dhe të njëjtat t'i harmonizojë me kërkesat e nevojshme.

Me theks të veçant tha se unë në bashkëpunim me stafin mbështetës të Komisionit, do ti inkorporojmë propozimet e dala nga anëtarët e Komisionit, me prioritet , çdo muaj të caktohen nga dy vizita, të identifikohen datat për ftesën e ministrave, dhe detyrimet për zbatimin e monitorimit të ligjeve.

Pas diskutimeve, kryetari, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxorri këtë:

Përfundim

Komisioni, miratoi Planin e Punës për vitin 2018, me propozimet e dhëna nga anëtarët, me qëllim të zbatimit të objektivave të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

Përgaditur nga:

Njësia mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simiq